



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e III-të të KPF-së e cila mbahet me datë: 20.03.2023 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i propozimit të DKRS-së për ndarje të mjeteve buxhetore për mbajtjen e festivalit folklorik "I këndojmë Lirisë",
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Shkurt-Mars 2023,
5. Të ndryshme.

01Nr. 06-8166 2023
Klinë, më 13.03 2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Oslonjajući se na član 52 Zakona br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, član 33 Statuta Opštine Klina, član 15, 16 i 17 Pravilnika Rada Skupštine i Skupštinskih Komiteta, Predsedavajući Komiteta za Politiku i Finansije Skupštine Opštine Klina izdaje sledeće:

OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi članovi Komiteta za Politiku i Finansije da prisustvuju IIIIm sastanku KPFA dana 20.03.2023 u Sali Skupštine Opštine Kline od 9.00 casova.

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje predloga DKRS za izdvajanje budžetskih sredstava za održavanje Smotre folkloru „Pevamo slobodi“.
4. Razmatranje podnetih zahteva Odboru za politiku i finansije za februar-mart 2023. godine,
5. Razno.

01Br. 06-8166 2023

Klina 13.03 2023



Predsedavajući,

Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA




Për:	Kuvendin Komunal, Kryesuesin e kuvendit z.Fadil Gashi
Nga:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Klinë, Drejtoresha: Fatjona Gashi
Lënda:	Kërkesë
Datë:	06.03.2023
Vendi:	Klinë



I nderuar kryesues z. Fadil Gashi

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kërkon nga ju që në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal në muajin mars, të vendoset pikë diskutimi dhe në votim ndarja e mjeteve buxhetore nga kategoria e subvencioneve në DKRS, për festivalin “I Këndojmë Lirisë” në vlerë prej 20.000€.

Me respekt!





Organizata e Veteranëve të Luftës të - UÇK - së
Shoqata e Invalidëve të Luftës të UÇK - së
Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK - së



Adresa Sheshi "Mujë Krasniqi"

Nr.Prot. 07/10/2023

Data :21.02.2023

01 451-5720/23

Për: Kryetarit Komunës së Klinës
 Nënkryetarën e Komunës së Klinës
 Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Klinës

Z. Zenun Elezi.
 Znj. Marqe Selmanaj
 z. Fadil Gashi

Nga : Tri Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së-Degët-Klinë.

Lënda: Kërkesë

Duke pasë parasysh gjendjen e rëndë të Organizatave të dala nga lufta e UÇK-së degët në Klinë, të cilat që nga themelimi i tyre nuk kanë kurrfarë burimi financiar institucional për funksionimin e tyre, në Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së degët në Klinë kërkojmë nga titulli i lartpërmendur conformë kompetencave që keni, të merrni vendim për mbështetje të rregullt financiare për funksionimin të këtyre shoqatave.

Në bazë të përlogaritjeve tona , për funksionimin e tri organizatave na duhet mbështetje financiare vjetore prej 15 000 euro.

Arsyetimi

Në këtë shumë të mjeteve të kërkuara janë përfshirë , pagat për stafin e tri organizatrave, shpenzimet për administratë, shpenzimet për përvjetore, shpenzimet për vizita familjevë të tri kategorive , shpenzimet për aktivitete të ndryshme në kuadër të datave të rëndësishme të UÇK-së të Komunës së Klinës dhe gjithë teritorit të Kosovës e më gjër.

Mbesim me shpresë që kjo kërkesë do të merrret parasysh si dhe të realizohet pozitivisht, Njëherit ju falënderojmë për mirëkuptim.

Më respekt bashkëpunimi;

Kryetari I OVL të UÇK-së
 dega Klinë
 z. Haldin Balaj



SHFD të UÇK-së
 dega Klinë
 znj. Bahri Haliti



SHIL të UÇK-së
 dega Klinë
 z. Vesel Berisha





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit nr. 03/ I - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2022, mori këtë

V E N D I M
PËR SUBVENCONIMIN E SHQËRTAVE TË DALA NGA LUFTA

I. **MIRATOHET** Vendimi për subvencionimin e shqërtave të dala nga lufta.

II. Shqërtat që do të subvencionohen janë:

- Shqërtat e anijve të Luftës së Ftohtë
- Shqërtat e Familjeve të Dëshmorëve të UCK-së - 2000.00 euro
- Shqërtat e Vërtanëve të Luftës së UCK-së - 2000.00 euro

III. Shuma e mjeteve të ndara sipas pikës I të këtij vendimi është 60,000.00 € (gjashtëdhjetë mijë euro), shuma këtu e siguruar nga kategoritë e subvencionimit.

IV. Mjetet e cekun në pikën III të këtij vendimi do të hartohen dhe shpërndahen shqërtave:

- Shqërtat e invalidëve të Luftës së UCK-së, me nr të krahëllimit nr. 11000000000000000000
- Shqërtat e Familjeve të Dëshmorëve të UCK-së, me nr të shpërndarjes: 010220770001875
- Organizata e Veteranëve të Luftës së UCK-së, me nr të shpërndarjes: 12300000000000000000

V. Shqërtat që do të përfitojnë nga subvencionimi janë të kategorisë që deri më 31.12.2021 të përfitojnë nga mjete të krahëllimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve për funksionimin e mjeteve.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi do të punëhohen Sekretari i Komunës dhe Drejtori Financiar.



Aziz Bajaj

today at 10:38 AM



NLB Banka sh.a.
Filiali Prishtinë
Rr. Ukshin Hoti Nr 124
10000 – Prishtinë, Kosovë
T: +381 (0) 38 744 100
F: +381 (0) 38 744 085
E: info@nlbprishtine-kos.com
www.nlbprishtine-kos.com

Sipas kërkesës së OVL TE UCK-SE ID: 5100340-3 evidencës me të cilën disponon Banka lëshohet ky:

KONFIRMIM MBI LLOGARINË

Me të cilin vërtetohet se OVL TE UCK-SE me ID: 5100340-3 ka të hapur llogarinë pran NLB BANKA

Nr llog 1701001010734491

Për Bankën NLB
Dt 08.12.2022





Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr _____/23

Klinë,dt: _____/23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 13.02.2023, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSB-në, drejtorët dhe të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i propozimit të drejtorisë për FEZH për bartje të mjeteve;
5. Shqyrtimi i propozimit të DUMM për destinimin e parcelës Nr.00109-0 ZK. Dollc-Klinë për ndërtimin e shtëpisë për të moshuarit;
6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin janar-shkurt 2023;
7. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Nuk na është kthyer konfirmimi ende prej vendimit të kuvendit nga Ministria e Pushtetit Lokal, në momentin që marrim konfirmim pastaj i shpërndajmë. Prandaj jemi veç pesë anëtarë të KPF-së, nuk e kemi ende as për Asdrenin, kështu që, këta që i kemi ftuar janë këtu prezent, që mund të procedojmë me mbledhje të rregullt edhe për rendin e ditës, duke shpresuar që e marrim edhe materialin. Unë po hap debat për rend të ditës, nëse ka dikush, urdhëroni, kush është për?

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 5 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, Kryesues: Te arsyetimi nuk kemi sepse jemi të gjithë prezent.

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 5 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, Kryesues: A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga seanca e kaluar?

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 5 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2022.

Fadil Gashi, Kryesues: Urdhëroni, drejtor, nëse dëshironi ta bëni një prezantim?

Enver Berisha, DFEZH: Përshëndetje kryesues, anëtarë të komitetit, ju të pranishëm! Realisht Raportin e punës e prezanton kryetari i komunës dhe besoj materialin ju e keni marr, por ne u dakordduam që, për shkak se ai është në bordin e drejtorëve, prezantimin e raportit ta bëjë në seancë. Kërkoj nga ju që kjo pikë të kalohet për asamble dhe në seancë kryetari e bën prezantimin e raportit.

Fadil Gashi, Kryesues: Po besoj edhe unë se e keni pranuar raportin. Deri në seancë besoj që ekzekutivi e bën një lekturim të faqeve, do të ishte shumë e nevojshme. E di se drejtori do të na ndihmojë në këtë drejtim, bile materiali i seancës me qenë pak më i kompletuar edhe i renditur në kuptimin edhe si tekst kështu edhe si faqe.

A ka dikush? Nëse nuk ka, a jeni për ta rekomanduar për Kuvend ? Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2022, rekomandoi që të bëhet një rishikim sa i përket radhitjes dhe lekturimit të tij deri në seancë, po ashtu rekomandoi që të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozimit të Drejtorisë për FEZH për bartje të mjeteve.

Fadil Gashi, Kryesues: Ju e keni pranuar sot një material, është një propozim nga drejtorja, për bartjen e shumës së kompensuar dhe i kemi programet dhe nënprogramet, për të cilat mendohet se ku të orientohen ato mjete. Pra, janë mjete që kanë tepruar nga viti paraprak. Drejtor, a ke ndonjë prezantim?

Enver Berisha, drejtor i DFEZH: Faleminderit kryesues, realisht kjo shifër që është këtu në vlerën e 1.322.000.00 është shifër që pjesa më e madhe është e bartur prej buxhetit të vitit të kaluar, ndërsa një pjesë mbi 300.000.00 është nga gjordat dhe dënimet që kanë ardhur këtu pas përfundimit të vitit kalendarik, realisht që hyjnë këtu në pjesën e projekteve për bartje. Ju me siguri i keni marr këtu edhe më herët shifrat që janë planifikuar, ky është një orientim që e kemi bërë me bartjen e drejtorëve që do të shkojnë për mjete, dmth ka projekte që fillojnë për herë të parë por ka projekte që kanë qenë edhe në kontratat dy- tre vjeçare, por kryesisht pjesa më e madhe janë projekte të reja. Nuk e di nëse tash ju si komitet a keni ndonjë reagim të shpërndarjes që e keni bërë, a po pajtoheni, me qenë se keni mundësi edhe për seancë me i dhanë vërejtjet e juaja, por, sido që të jetë mbi fazën e projekteve dhe nevojave që ekzekutivi i ka vlerësuar, ne, kemi ardhur me këtë planifikim për bartjen e këtyre mjeteve. Nëse ka dikush diçka konkrete rreth një çështje të caktuar, kjo ende nuk është krejt përfundimtare, derisa të na kthehet tash nga Ministria e Financave, mirëpo deri në seancë e dimë a ka ndonjë lëvizje a jo, por, përgjithësisht është ky planifikim që ne e kemi bërë për bartjen e këtyre mjeteve. Faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit drejtor, unë po hapi debat, po, Tunë Dedaj?

Tunë Dedaj: Përshëndetje për ju dhe për të gjithë të pranishmit! Unë e pash dhe e lexova me vëmendje dhe e përkrahi këtë shpërndarje që e keni bërë dhe është shumë e mirë, bile kisha ndërmend që të angazhohem se duhet sa më shumë mjete për rregullimin e parqeve, por qenkan të parapara edhe ne e mbështesim këtë mënyrë, le të shkojë në Kuvend.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit Tunë, dikush tjetër?

Enver Berisha, drejtor i DFEZH: Kryesues, desha ta jap një informacion, dmth përveç kësaj shume që është këtu, ne e kemi edhe shumën e performances që është 760.000.00 euro. Pra, ju e dini që nuk shkon përmes kuvendit, janë mjete që ekzekutivi i orienton se kah, po veç informatë dmth, tash në këtë periudhë faktikisht janë mbi 2.000.000.00 euro që janë planifikuar në harxhimin e shumë projekteve që komuna ka nevojë.

Fadil Gashi, Kryesues: Po, faleminderit! A ka dikush, kush është për ta rekomanduar për kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që kërkesa për bartje të mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit 2022 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i propozimit të DUMM për destinimin e parcelës Nr.00109-0 ZK. Dollc-Klinë për ndërtimin e shtëpisë për të moshuarit.

Fadil Gashi, Kryesues: Ju e keni marr një material që drejtorja e sqaron por e kemi edhe drejtorin këtu nëse ka diçka, urdhëro drejtor

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Përshëndetje kryesues, anëtarët e komisionit, ju të pranishëm! Unë ju kam drejtuar Kuvendit me një pikë e cila është për destinimin e një parcele e cila është shumë e përshtatshme për ndërtimin e shtëpisë së të moshuarve. Komuna e ka marr përsipër të fillojë ndërtimi i një shtëpie për të moshuarit, ndërsa sipas hartës zonale vendi më i përshtatshëm është ky vend i cili është caktuar sepse i plotëson gjithashtu kriteret, mirëpo kjo parcelë figuron në emër të një shkolle e cila duhet medoemos që të destinohet për ndërtim, është zona ZB2 e cila i përfshin edhe çështje sociale dmth nuk është kundër hartës zonale mirëpo duhet ta ndërrojë destinimin e krejt shkollës sepse është pronë shoqërore e shkollës, por në fakt, sipas hartës zonale është zonë banuese ose zonë ZB2 e cila në kuadër të saj mund të hyjnë, të lejohen edhe ndërtime të veçanta siç janë edhe çështje sociale, faleminderit.

Tunë Dedaj: Po kryesues, me thënë të drejtën unë dua t'i falënderoj ata që kanë menduar edhe ata që e kanë zgjedhur atë vend për t'u ndërtuar kjo shtëpi e të moshuarve, se aty do të thotë është vendi më i mirë i mundshëm që sot për sot e ka komuna e Klinës, kaq.

Fadil Gashi, Kryesues: A ka dikush ? Edhe unë duke ju falënderuar se kanë nevojë si kategori që ta kenë një vend dhe një përkujdesje edhe të trajtohen ashtu si e meritojnë, si kategori e të moshuarve. Nëse s'ka, kush është për ?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga DUMM, për ridestinimin e parcelës për ndërtimin e shtëpisë për të moshuar, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin janar-shkurt 2023.

Kërkesa 1

Kërkesë nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së për dhënie në shfrytëzim 20 ari tokë në kodrën e fshatit Gremnik, për vendosjen e tre shkronjave të UÇK-së dhe ndërtimin e parkut i cili do të emërohet parku i UÇK-së.

Fadil Gashi, Kryesues: Besoj që drejtori i urbanizmit e di ku është si zonë, unë mandej e di mirë, por telashi është se nuk është pronë e komunës, është pronë e Agjencionit të pyjeve, i kemi mbikëqyr edhe me Ahmetin ato parcela por të dyja janë në emër të Agjencionit të pyjeve. Projekti si projekt po besoj për ata dhe për mua është i pranueshëm, sepse e ka një pamje përnjëmend të mirë, është vend që mund të vërehen ato tre shkronja. Po, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Faleminderit kryesues, këso raste kemi mjaft që na vijnë kërkesat për me marr se faktikisht zona e AKP-së asht zonë pyjore, ndodh që nuk shkon përmes

kuvendit, duhet të marrin një vërtetim që a ka planifikuar diçka komuna prej Drejtorisë për Urbanizëm, pastaj t'i drejtohet njësisë përkatëse, në qoftë se është e AKP-së do t'i drejtohen AKP-së edhe ata pastaj vazhdojnë, kështu që, unë thash veç sa për konfirmim se ajo nuk mund të shkojë përmes kuvendit .

Tunë Deda: Ne e përkrahim, është iniciativë shumë e mirë edhe është mirë me u gjet mënyra edhe ju të angazhoheni në maksimum që atyre me jua dhanë atë pjesë, do të thotë me ju gjet çfarëdo mënyre që është e mundshme, nëse ka nevojë edhe kuvendi i komunës me ble prej AKM-së atë pjesë edhe me ju dhanë shoqatave atë vend, me rregulluar bukur se përnjëmend është vend i mirë edhe është i nevojshëm.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit Tunë, edhe unë po pajtohem që me dhanë mbështetje dhe nëse është nevoja, nëse ka mundësi edhe në ato transaksione, por paraprakisht ata duhet të shkojnë të bisedojnë çfarë vullneti kanë pronarët e saj dhe ne shikojmë pastaj, ne si kuvend çka mund të ndihmojmë, a ka dikush tjetër? Nëse nuk ka, ne duhet të formulojmë një përgjigje që ne e mbështesim si projekt ndërsa te pronari i parcelës, ata të ju drejtohen pronarit edhe ne me mbështet veç si projekt kështu si është .

Tunë Dedaj: E mbështesim dhe jemi në gjendje edhe të paguajmë, nëse ka nevojë.

Fadil Gashi, Kryesues: Po edhe në forma tjera, nëse dalin kërkesa të reja, kush është për?

Pas shqyrtimit të kërkesës në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe verifikimit të pronës së kërkuar nga OVL, u konstatua që vendi i kërkuar nga OVL nuk është pronë shoqërore e Komunës së Klinës, por pronë e pylltarisë Sharri, andaj Komiteti rekomandoi që Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së t'i drejtohet me kërkesë pronarit të parcelës, pylltarisë Sharri. Ndërsa nëse është e nevojshme ndihma në forma të tjera, nga komuna do të ketë mbështetje.

Kërkesa 2.

Paraqitësja e kërkesës: Nazife (B.) Gucati nga Klina.

Si fillim me lejoni që t'ju falënderoj për ndihmën që me keni ofruar vazhdimisht dhe që vazhdoni të më ndihmoni akoma. Unë dhe fëmijët e mi ju jemi tejet mirënjohës Kryetarit, Nënkyetares dhe çdo personi tjetër që kontribuoj sado pak në zgjidhjen e problemit tonë për strehim të përkohshëm, në kohën kur unë si viktimë e dhunës në Familje më së shumti kisha nevojë. Mirëpo, me keqardhje duhet të ju njoftoj se përkundër përpjekjeve të mia për punësim apo vetëpunësim, nuk arrita të punësohem dhe në pamundësi të përmirësimit të gjendjes time ekonomike, po detyrohem t'ju drejtohem edhe njëherë ju si Kuvend për të më ndihmuar në pagesën e qirasë. Momentalisht unë me dy fëmijët e mi jemi duke jetuar në banesë me qira prej 250 euro, ku shuma të cilën me keni ndihmuar më parë nuk më mjafton për muajt në vazhdim. E si rezultat i kësaj ndihmi të rrezikuar se në këto ditë të ftohta do të mbesim pa strehë mbi kokë. Gjendja ime ekonomike është shumë e dobët.

Unë nuk kam pronë time të trashëguar apo çfarëdo qoftë tjetër mbi vete, jetoj në një gjendje të rëndë ekonomike, e çka më sjell edhe para sfidave të mëdha sociale.

Andaj unë N. G. kërkoi nga institucioni i lartcekur që të marrë parasysh kërkesën dhe nevojën time urgjente dhe të na bën një zgjidhje duke më ndihmuar financiarisht për strehim të përkohshëm deri në një zgjidhje definitive të një banimi.

Me përgjegjësi të lartë morale deklaroj se jetoj në kushte jo të mira ekonomike.

Tunë Dedaj: Kryesues, edhe unë jam që kësaj t'i jepet mbështetje, por të shikohet mundësia t'i gjendet një banesë me qira më e vogël, se në Klinë 250 euro është shumë jo e mirë me e pa dikush nëse i paguhet kjo shumë, nuk e di se ka banesë në Klinë 250 euro, kjo nuk ka nevojë me qenë aq banesa e madhe, ka nevojë 50 metra katror me i pas.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit Tunë, a ka dikush? Jemi të obliguar të kthejmë një përgjigje si KPF ose ta rekomandojmë në kuvend ose në zyrën e kryetarit, ai veç e ka një vendim prej kuvendit, që ne kemi marr vendim me ju ndarë mjetet edhe me ja paguar banesën, por unë tash me ju thënë të drejtën nuk jam i sigurt në çmim, as qysh e kemi pasur çmimin më parë, çmimin e përgjithshëm 1000 euro po për muaj nuk e di, deri kur të shkojmë në kuvend le ta sqarojnë. Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës nga N. G. nga Klina, për subvencionim të qirasë së banimit, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 7. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: A ka dikush rreth kësaj pike? Nëse nuk ka, atëherë unë po ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim, shihemi në takimin e radhës!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

KRYESUESI,
Fadil Gashi

Për: Drejtorin e Shërbimeve Publike, Komuna e Klinës

Nga: Banoret e fsh. Gllarevë, Rixhevë dhe Stapanicë

Lënda: Kërkesë për caktimin (ndërrimin e destinimit) të parcelave për varreza

Ne banoret e fshatrave Gllarevë, Rixhevë dhe Stapanicë të Komunës së Klinës, aktualisht nuk kemi sipërfaqe të tokës se ku ti vendosim apo ti varrosim personat që vdesin.

Kërkojmë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komuna e Klinës që të na ndaj parcelat kadastrale me nr. P-71010034-00661-0 me sipërfaqe 1757 m², parcela me nr. P-71010034-00659-0 me sipërfaqe 13759 m², dhe parcela me nr. P-71010034-00658-0 me sipërfaqe 5742 m² si dhe parcela me nr. P-71010034-00657-0 me sipërfaqe 8003 m², ku të gjitha këto parcela gjenden në Zonën Kadastrale Gllarevë, Komuna e Klinës.

Ne si banor vazhdimisht kënaqem bërë kërkesa të natyrës së tillë por asnjë herë nuk kënaqem marrë përgjigje lidhur me këtë çështje.

Të bashkangjitura me këtë kërkesë i kemi listën e nënshkrimeve të banoreve të fshatrave Gllarevë, Rixhevë dhe Stapanicë, pëlqimin e institucioneve fetare Islame, fletën poseduese të parcelave të përmendura në këtë kërkesë si dhe ortofoton e parcelave.

Ali Morina, Gllarevë,  Ali Morina

Emin Balaj Gllarevë  Emin Balaj

Muhamet Morina Rixhevë  Muhamet Morina

Imer Morina Rixhevë  Imer Morina

Rasim Maliqaj  Rasim Maliqaj

KOSOVA	
20.02.2023	
Org. n. 1/2023	
08	352-5368/23

Klinë, dt. 20.02.2023